



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 23 janar 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Arsim Bajrami, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivkoviq.

Mungoi: Albulena Haxhiu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumniye Murati- ZPRK, Etrur Maloku – US Embassy, Edon Myftari - këshilltar ligjor – NDI, Artan Canhasi – EULEX, Luz Balaj – NDI, Alban Bokshi – KPJ, Flutura Kusari – Birn dhe Eroll Gashi – student.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për ndihmë juridike falas,
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L- 88 për Arkivat,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për ndihmë juridike falas

Kryetari paraqiti për shqyrtim raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndihmë juridike falas, ku ka propozuar amendamente për nenet: nenit 15, nënparagrafi 1.3; nenit 20, paragrafët 1 dhe 3; nenit 22, paragrafi 2.2, nënparagrafi 2.3; nenit 37, paragrafët 1 dhe 2 dhe nenit 39, dhe kërkoi që të përkrahen, sepse disa herë radhazi është kthyer nga seanca, dhe mendoi që ky ligj nuk to të jetë i zbatueshëm.

Armend Zemaj - Tha se krijimi i mekanizmave shtesë që e rëndojnë buxhetin e Kosovës, pa arsye, sidomos agjencive dhe këshillave, jo vetëm që nuk e avancojnë ndihmën juridike falas, por do të ketë edhe probleme gjatë zbatimit. Komisioni për buxhet është munduar t'i zbusë ndikimet buxhetore, por nuk ka arritur që t'i fusë edhe ato kërkesa që kanë dalë nga seanca plenare dhe atë çfarë ne, si Komision, kemi kërkuar. Për këto arsye unë abstenoj.

Në momentin e votimit prezent ishin tetë anëtarë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 4 vota “ për “, 2 vota “ kundër” dhe 2 abstenime, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Projektligji për ndihmë juridike falas Nr. 04/L-17 me amendamentet e propozuara nga komisionet.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 04/L- 88 për Arkivat

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 04/L- 88 për Arkivat dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji për Arkivat, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi se më 25.01.2012 do ta mbajmë dëgjimin publik për PL për marrëdhëniet e detyrimeve.

Behar Selimi -I njoftoi se grupi punues për projekt- kodin penal ka filluar punën dhe është përcaktuar metoda punës dhe kërkoi që sa më parë të caktohen edhe ekspertët për këtë projekt- kod. Ai kërkoi që ekspertët që kanë marrë pjesë në grupe punuese në ministri të mos përfshihen edhe një herë. Si ekspertë që janë propozuar, dhe për të cilët kërkohet edhe mendimi i Komsionit janë: Bajram Ukaj dhe Rexhep Gashi nga Fakulteti Juridik, Besim Kelmendi nga Prokuroria Speciale dhe Mejdi Dehari nga Gjykata e Qarkut.

Armend Zemaj - Propozoi Rexhep Gashin dhe sqaroi se nuk ka marrë pjesë në hartim në nivel të ministrisë, dhe kemi një përvojë të mirë nga legjislatura e kaluar.

Komisioni vendosi që të kontaktohen kandidatet e propozuar dhe të sqarohet nëse ata kanë marr pjesë në hartim në nivel të ministrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi